



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:010700

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645868

KPPP.nr. 73/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 2059/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., me seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 2059/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 2059/23, i lejuar më datë 21.12.2023, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, MBETE NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbarimor; Vendimit 01 Nr. 50-195/2022, të datës 18.10.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 2059/23, të datës 21.12.2023, me të cilin është obliguar debitori NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, kreditorit t’ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 2,000.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se çështja lidhur me vendimin nr. 50-195/2022 është ende në

procedurë, ashtu që bazuar në vendimin Nr. IP 178 të datës 18.05.2023 ka parashtruar padi për konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, Departamenti Administrativ me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit Nr. IP 178, të datës 18.05.2023 dhe vendimit 01 Nr. 50-195/2022. Andaj, ka shtuar se meqë vendimi ende nuk është përfundimtar i njëjti nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbartim. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbartim e ka parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare për pagesë të gjobës së shqiptuar sipas vendimit të formës së prerë të TEIP. Ka shtuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor është i bazuar dhe i ekzekutueshëm, si dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi 01 Nr. 50-195/2022, i datës 18.10.2022, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, është bërë i plotfuqishëm dhe mban vullën e ekzekutueshmërisë së datës 18.05.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e

përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk është i plotfuqishëm ngase ndaj të njëjtit është iniciuar konflikti administrativ në gjykatë, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase padia e paraqitur në gjykatë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për konfliktet administrative, me të cilin përcaktohet se “*Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 73/24, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.